

INFORMACION PËR
POLITIKËN MONETARE

Dr. Dennis E. Farley

Bordi i Drejtorëve, Rezerva Federale

INFORMACION PËR POLITIKËN MONETARE

1. HYRJE

Dëshiroj të falenderoj Bankën e Shqipërisë për ftesën që më bëri për të folur në këtë konferencë. Dua, gjithashtu, të falenderoj punonjësit e Departamentit të Kërkimeve, të cilët ishin mikpritës mjaft të këndshëm gjatë qëndrimit tim në bankën qendrore.

Pjesa e parë e këtij prezantimi hedh një vështrim në kërkesat për informacion për qëllime të politikës monetare. Ajo fillon me një përkufizim shumë të thjeshtë të politikës monetare dhe tregon disa nga implikimet e këtij përkufizimi, të cilat ka nevojë t'i dijë një bankë qendrore. Më pas trajtohet roli, që luan regjimi i *inflation targeting* në organizimin e informacionit.

Pjesa e dytë e prezantimit fillon me një diskutim për shkëmbimin e informacionit, një nga aspektet më të rëndësishme për një politikë monetare efikase. Shembuj mbi faktin se si mblidhet informacioni për politikëbërësit paraqiten në vazhdim duke iu referuar mënyrës se si kryhet kjo gjë në Rezervën Federale.

Më lejoni të paraqes që në fillim konkluzionet e mia. Misioni i bankës qendrore imponon kërkesa të caktuara për informacion. Lista e saktë për nevojat e bankës qendrore varet nga synimet e saj. Për shembull, *inflation targeting*, jep si qëllimin e bankës qendrore ashtu edhe një mënyrë për të menduar mbi nevojat për informacion. Përdorimi efikas i informacionit për politikën monetare kërkon që informacioni të shkëmbehet brenda bankës qendrore dhe midis agjencive qeveritare. Në momentin kur sigurohet informacion i mirë, ai duhet paraqitur në një mënyrë të kuptueshme për politikëbërësit.

2. PJESA E PARË - KËRKESAT E BANKËS QENDRORE

2.1 ÇFARË ËSHTË POLITIKA MONETARE ?

Politika monetare mund të përkufizohet si administrim i parasë dhe ka përmasa të brendshme dhe të jashtme. Përmasa e jashtme nënkupton që administrimi i parasë angazhon kurset e këmbimit ose çmimin e parasë tuaj në raport me të tjerat.

Përmasa e brendshme nënkupton që administrimi i parasë merr në konsideratë çmimet e mallrave dhe të shërbimeve brenda vendit dhe ndryshimet në nivelin e përgjithshëm të këtyre çmimeve, ose inflacionin.

Midis dy përmasave të politikës monetare, asaj të brendshme dhe të jashtme, ekzistojnë lidhje. Për shembull, nëse paraja juaj zhvlerësohet në raport me monedhat e tjera, kostoja e mallrave që ju importoni, e shprehur në monedhën tuaj, do të rritet dhe po kështu edhe madhësia e inflacionit të brendshëm.

Ose, nëse banka qendrore kufizon ofertën e parasë brenda vendit dhe për pasojë projekton rritjen e normave të brendshme të interesit, mund të kemi hyrje kapitali në vendin tuaj, gjë e cila rrit kërkesën për para dhe shkakton rritje të kursit të këmbimit.

Është pranuar gjerësisht që, për periudha afatgjata, politika monetare ndikon në sasi emërore (nominal) si për shembull niveli i çmimeve. Megjithatë, ekonomitë në realitet nuk janë sisteme të ekuilibrit të përgjithshëm të teorisë ekonomike. Ato përbëhen nga një grup institucionesh që, për më mirë ose për më keq, gjenerojnë fërkime (legjisacionin, doganat lokale, kostot e rregullimit etj.), që ndërhyjnë me një rregullim të menjëhershëm të çmimeve të kërkuara për të pastruar të gjitha tregjet njëkohësisht. Për pasojë, të paktën për periudha afatshkurtra, politika monetare mund të ketë efekte të forta në sasi të reale si prodhimi dhe punësimi.

Në pjesën më të madhe të ekonomive moderne, administrimi i parasë i besohet një banke qendrore. Nevojat për para kanë nevojë të administrohen, sepse pjesa më e madhe e vendeve kanë abandonuar standardet e mallit, siç është ai i arit, ndryshimi i ngadaltë i ofertave të të cilave tentoi automatikisht të

kufizonte sasinë e parasë në qarkullim. Për pasojë, banka qendrore mori përsipër funksionin e përcaktimit të vlerës së parasë¹.

2.2 ÇFARË KENI NEVOJË TË DINI PËR TË BËRË POLITIKË MONETARE ?

Edhe me këtë përshkrim shumë të shkurtër të politikës monetare, jemi në gjendje të supozojmë disa kërkesa, që duhet të ketë një bankë qendrore për informacion. Natyrisht, ajo duhet të dijë se sa para është emetuar dhe sa është kthyer, me qëllim që të mund të llogaritet në çdo kohë sasia në qarkullim. Përveç kësaj, ajo duhet të dijë sasinë e rezervave, që institucionet depozituese mbajnë në bankën qendrore. Këta dy përbërës, paraja dhe gjendja e rezervave, formojnë bazën monetare, të cilës shpesh i referohemi edhe si paraja rezervë.

Më tej, banka qendrore ka nevojë të jetë e vetëdijshme për veprimet e saj dhe ato të tjerëve, që ndikojnë në sasinë e parasë rezervë. Për të bërë këtë, banka duhet të mbikëqyrë nga afër bilancin e vet. Meqenëse depozitat e bankave kanë mjaft funksione të njëjta si paraja, banka qendrore duhet, gjithashtu, të sigurojë të dhëna nga bilancet e bankave dhe të institucioneve të tjera depozituese.

Banka qendrore ka nevojë të ketë informacion për kurset e këmbimit. Më pas, ajo kërkon të ketë një matje të mirë për inflacionin e brendshëm. Ajo, gjithashtu, do të mbikëqyrë kanalet nëpërmjet të cilave politika monetare ndikon në prodhimin real dhe në punësim. Meqenëse këto kanale ka të ngjarë të angazhojnë tregjet financiare, ka nevojë për të dhëna mbi sasinë dhe çmimet në tregjet e parasë dhe të kapitalit. Së fundi, banka qendrore ka nevojë të ketë disa tregues të aktivitetit real për të ditur se cilat kanë qenë efektet e saj.

Në fund, banka qendrore do të dijë çdo gjë për ekonominë. Është e vërtetë që sa më komplekse të jetë ekonomia juaj dhe sa më të integruara të jenë tregjet financiare, aq më shumë keni nevojë të posedoni informacion. Fatmirësisht, është e mundur të bëhet politikë monetare efikase edhe me njohuri shumë më pak se njohuritë e plota. Por, përpara se të përpilohet lista e asaj që është e rëndësishme, është e dobishme të shqyrtohet më tej qëllimi i politikës monetare.

2.3 ROLI I INFLATION TARGETING²

Inflation targeting ofron një kuadër për politikën monetare. Mbi të gjitha, ai ofron qëllimin. Banka qendrore drejtohet, zakonisht e përcaktuar në legjisllacion, kah mbajtja e stabilitetit të çmimeve, ku stabiliteti i çmimeve përcaktohet ose si inflacion zero ose si një normë e ulët pozitive inflacioni.

Teoria, që mbështet këtë metodë është që individët dhe ndërmarrjet veprojnë me më efikasitet kur vendimet e tyre bazohen në sasinë reale. Stabiliteti i çmimeve do të thotë që, në përgjithësi, sinjalet nominale nga tregje, gjithashtu, masin sasi reale.

Së dyti, *inflation targeting* përqendron vëmendjen në faktin se ç'mendojnë pjesa më e madhe e njerëzve mbi atë se çfarë kontrollojnë faktikisht banka qendrore në periudha afatgjata. Ky objektivi është i arritshëm dhe është, gjithashtu, i shpjegueshëm për publikun.

Një aspekt i tretë i *inflation targeting*, dhe ai tek i cili unë dua të përqendrohem, është që ai ndihmon organizimin e kërkesave për informacion të bankës qendrore. Së pari, dhe mbi të gjitha, duhet të ketë një matje të besueshme të çmimeve të produkteve. Në pjesën më të madhe të rasteve këtij treguesi i referohemi si indeksi i çmimeve të konsumit.

Tjetër, pasi të njihet fakti që veprimet e bankës qendrore duan njëfarë kohe që të ndikojnë në ekonomi, ka nevojë të adoptohet një metodë që sheh nga e ardhmja. Kjo do të thotë parashikim të inflacionit si edhe masa parashikuese për presionet mbi çmimet, siç janë çmimet në faza të hershme të prodhimit ose pagat. Parashikimi i inflacionit do të bazohet në mënyrën se si ju mendoni që ndryshimet në politikën monetare do të filtrohen nëpërmjet ekonomisë tuaj (procesi i transmisionit) dhe në instrumentet politike të disponueshme (veprimet në tregun e hapur, kërkesat për rezervën e detyrueshme, kufijtë e kreditit e kështu me rradhë).

¹ Bankat qendrore, nga pikëpamja historike, janë institucione relativisht të reja. Një shekull më parë, kishte vetëm 18 banka qendrore, kryesisht në Europë. Sot ka 172 banka qendrore, ose afërsisht një bankë për çdo vend.

² *Inflation targeting*, duke qenë një metodë për të bërë politikë monetare, varet nga disa kushte paraprake, dhe jo të gjitha këto plotësohen në Shqipëri. Por, është e dobishme të merret parasysh se çfarë na tregon *inflation targeting* për kërkesat për informacion të bankës qendrore dhe këtu është përqendruar vëmendja në këtë pjesë.

Shkurtimisht, *inflation targeting* ndihmon në organizimin e asaj se ç'ka përpiqet të dijë banka qendrore. Duke supozuar që objektivi juaj është stabiliteti i çmimeve (objektivi i përcaktuar me ligj për Bankën e Shqipërisë), atëherë të dhënat që do të duheshin janë:

çmimet e konsumit;
çmimet e produkteve në fazat e hershme të prodhimit;
pagat;
matjet e ofertës dhe kërkesës agregate;
PBB;
punësimi dhe papunësia;
bilanci i pagesave.

Elementet e procesit të transmissioinit :

kurset e këmbimit;
stoku i parasë;
kredia bankare dhe kredi të institucioneve të tjera;
normat e interesit të tregut kapital;
çmimet e aksioneve.

Instrumentet politike :

paraja rezervë;
pjesa që mbetet e bilancit të bankës qendrore;
normat e interesit të tregut të parasë.

Ju mund të mos i keni të gjitha këto të dhëna. Është e qartë, që nëse nuk keni matje të çmimeve, nuk mund të angazhoheni në *inflation targeting*. Do t'ju duhet të lidheni pas një objektivi tjetër si për shembull, agregatit monetar ose të kredisë apo të kursit të këmbimit.

Duke supozuar që dispononi të dhëna për çmimet, mund të mos keni llogari kombëtare, dhe për pasojë, as informacion të besueshëm për PBB. Kjo nuk do të përjashtojë plotësisht mundësinë e adoptimit të *inflation targeting*, por do të keni nevojë për përafrime (siç janë shitjet me pakicë ose prodhimi industrial) që mendoni se janë të lidhura me përbërësit e PBB-së. Këto përafrime ndihmojnë për të vlerësuar se cilat janë efektet e politikës monetare në ekonominë reale në periudhë afatshkurtër. Ju mund t'ju mungojë integrimi i mirë i tregjeve financiare, gjë e cila kufizon sasinë e të dhënave të tregjeve të parasë dhe të kapitalit të cilat do të ishit në gjendje t'i mblidhni. Më tej, mungesa e tregjeve të tilla dhe të dhënat financiare që shoqërojnë ato nuk do të pengojnë përcaktimin e *inflation targeting* si objektiv.

Megjithatë, kjo sugjeron që mekanizmi i transmissioinit në vendin tuaj është i ndryshëm nga ai i disa vendeve të tjera. Ndoshta, kanalet më të rëndësishme për politikën monetare në ekonominë tuaj do të jenë ndikimi në kursin e këmbimit ose në gjendjen reale apo madje edhe të disponueshmërisë së kredisë.

Disa nga të dhënat e listuara mblidhen në mënyrë rutinë nga banka qendrore ose nëpërmjet veprimeve të saj të zakonshme ose nëpërmjet rolit si mbikëqyrës i sistemit financiar. Por, ngrihen edhe çështjet e trajtimit të administrimit të informacionit.

Si rregull, mblidhen edhe seri të tjera të dhënash nga agjenci të ndryshme qeveritare apo edhe nga grupe private. Për të siguruar këto, banka qendrore duhet të vendosë një lloj bashkëpunimi midis saj dhe prodhuesve të statistikave. Këto çështje janë trajtuar më të detajuara në vijim.

3. PJESA E DYTE - ASPEKTET PRAKTIKE

3.1 SHKËMBIMI I INFORMACIONIT

3.1.1 Brenda bankës qendrore

Informacioni është pushtet. Nëse në një transaksion di më shumë se homologu yt, ka të ngjarë të përfundosh një marrëveshje më të mirë në fund. E njëjta logjikë vepron edhe ndërmjet organizatave,

nëse di më shumë se kolegët e tu, ka të ngjarë të krijosh një reputacion si “personi që ka çdo përgjigje” dhe paga e mbështetja juaj do ta pasqyrojnë këtë gjë.

Fatkeqësisht, në burokraci, ky fakt punon kundër shkëmbimit të informacionit. Nxitja që do t'i kundërvihej kësaj tendence për të mbajtur informacionin për vete ose brenda departamentit nuk ekziston gjithmonë.

Për të shmangur rezultate të tilla në bankën qendrore, drejtuesit, nga Guvernatori e në nivele të mëposhtme, kanë nevojë të rrënjosin një kulturë bashkëpunimi.

Duke filluar me idenë që objektivi është bërja e një politike të mirë monetare, çdo nivel administrimi ka nevojë të mendojë se si mund të kontribuohet për këtë qëllim duke punuar me pjesët e tjera të bankës.

Një shembull i thjeshtë do të ilustrojë këtë çështje. Supozojmë që Departamenti i Mbikëqyrjes zbulon nëpërmjet procesit të zakonshëm të mbikëqyrjes së sistemit bankar që cilësia e portofolit të huave të bankës është përkeqësuar shumë.

Në të njëjtën kohë, Departamenti i Kërkimeve përgatit një vlerësim periodik të ekonomisë dhe të ndikimeve të mundshme të ndryshimeve në politikën monetare. Nëse Departamenti Kërkimeve nuk e di këtë informacion të ri për cilësinë e huave, ai do të nënvlerësojë rrezikun e një krize bankare nëse ekonomia është në rënie. Për pasojë, do të nënvlerësohet rreziku i shtrëngimit të politikës monetare.

Mund të thoni, që në këtë shembull, të dyja departamentet mund të paraqesin raporte tek Guvernatori dhe ai mund të kombinojë gjithë informacionin, duke korrigjuar raportin e Departamentit të Kërkimeve sipas drejtimit të duhur. Kjo metodë ka brenda shumë supozime. Ajo supozon që Guvernatori ka kohë të disponueshme për të bërë kombinimin, dhe supozon që ai posedon dhe aftësi për një numër të madh fushash me qëllim që të jetë në gjendje ta bëjë këtë gjë. Por, nëse Guvernatori mund ta bëjë gjithë këtë veprim, pse kanë punonjës bankat qendrore? Një metodë shumë më e mirë është që punonjësit, në nivel nën politikëbërësit, të konkludojnë me një kënvështrim të vetëm. Kësaj i referohemi shpeshherë si “të folurit me një zë”. Kjo nuk i pret rrugën opinioneve të ndryshme ose debatit ndërmjet punonjësve, por kjo kërkon që punonjësit të gjejnë konsensus. Për të arritur konsensusin, punonjësit kanë nevojë të bashkëpunojnë, si brenda departamentit dhe midis departamenteve. Një element thelbësor i bashkëpunimit në burokraci është shkëmbimi i informacionit.

Si e nxit një bankë qendrore shkëmbimin e informacionit? Siç e përmenda më sipër, kultura e bashkëpunimit duhet të vijë nga drejtuesit. Guvernatori dhe Zëvendësguvernatorët duhet të kërkojnë që departamentet të punojnë së bashku. Por, edhe pasi të jetë injektuar një kulturë e tillë, disa përcaktime në rang institucioni e ndihmojnë vazhdimin e bashkëpunimit.

Për shembull, një mënyrë e mirë për të vendosur dhe pastaj ruajtur bashkëpunimin është që Zëvendësguvernatorët të krijojnë projekte, që angazhojnë disa departamente për planet e punës kërkimore të bankës dhe të përballohen këto projekte nga buxhetet e çdo departamenti.

Një mënyrë tjetër për të nxitur shkëmbimin e informacionit është që të posedohet i gjithë informacioni, i cili nuk klasifikohet si konfidencial, në një bazë të dhënash të centralizuara të përdorshme nga të gjithë punonjësit³. Kjo nënkupton diskutimin e bazës së të dhënave dhe kërkesa për programe kompjuteri nëpër departamente dhe vendosjen e një komiteti me përfaqësim të gjerë të bankës për të vepruar në këtë mënyrë.

Përfitimi nga të pasurit e një baze të dhënash të centralizuara, lehtësisht të përdorshme vjen në formën e ideve të reja.

Nganjëherë, njerëz të tjerë mund të shohin se si mund t'i përdorin të dhënat tuaja në mënyra të tilla, që ju mund të mos kishit menduar. Në fillim kjo mund të mos duket si përfitim. Në fakt, kur kjo gjë më ndodhi mua në Rezervën Federale, fillimisht u shqetësova kur mendoja se përse nuk mendova vetë për këtë novacion. Por, rezultati përfundimtar zakonisht është një memo ose një material, duke përdorur të dhënat e mia në një mënyrë të re, që çon më tej misionin e Sistemit të Rezervës Federale. Unë mund të jem një bashkëautor i kësaj pune, ose edhe thjesht një këshilltar për të dhënat, por cilido që të jetë roli im, unë përsëri fitoj besim nga mbikëqyrësit e mi. Reagimi pozitiv, që marr unë prej tyre në formën e rivlerësimit të rezultatit të mirë në punë më nxit për të bashkëpunuar përsëri në të ardhmen në vend që ta kufizoj mundësinë e përdorimit të të dhënave të mia me qëllim që unë të jem i vetmi “ekspert” në bankë.

³ Sigurisht që askush nuk do që pagat e punonjësve të mund të shihen nga çdokush dhe po ashtu mund të ketë të dhëna të bankave të veçanta tregtare përdorimi i të cilave ka nevojë të kufizohet, por, pothuaj çdo gjë tjetër duhet të jetë e disponueshme.

3.1.2 Jashtë bankës qendrore

Pjesa më e madhe e çështjeve të trajtuara më sipër vlejnë edhe për sigurimin e të dhënave nga agjencitë apo nga grupet e tjera, por problemet shumëfishohen. Në veçanti, nuk ka një grup të vetëm drejtuesish që të mund të përçojë kulturën e bashkëpunimit. Në parim, Këshilli i Ministrave, ose edhe Kuvendi, mund të sigurojnë drejtimin e nevojshëm. Megjithatë, në këtë nivel, konsideratat politike mund të imponohen në dëm të shkëmbimit të informacionit. Përveç kësaj, dëshira për të mbetur i pavarur nga pjesa tjetër e qeverisë mund të ulë gatishmërinë e bankës qendrore për të bashkëpunuar shumë ngushtë me ministritë ose agjencitë e tjera qeveritare.

Këto probleme të bashkëpunimit ndërmjet njësive qeveritare mund të të shkurajojnë, por ato mund të zgjidhen. Zgjidhjet, edhe një herë, angazhojnë krejt punonjësit e bankës qendrore, nga Guvernatori deri në nivelin më të ulët. Guvernatori mund të takohet periodikisht me Ministrin e Financave dhe me ministra të tjerë me funksione ekonomike. Presidenti i Bordit të Rezervës Federale, për shembull, takohet shpesh me Sekretarin e Thesarit, i cili është ministri ynë i financave. Kuptohet lehtësisht, në këto takime, që Sekretari nuk i tregon Guvernatorit se çfarë duhet të bëjë, por këto takime ofrojnë një mundësi për shkëmbimin e pikëpamjeve.

Anëtarët e tjerë të Bordit të Rezervës Federale, duke u alternuar, japin dreka çdo javë për punonjësit e nivelit të lartë të Rezervës Federale dhe të Thesarit.

Këto takime prekin çështjet e administrimit të borxhit, çështjet e ekonomisë ndërkombëtare, politikën rregullatore dhe perspektivën ekonomike. Përsëri, Thesari tregohet mjaft i kujdesshëm për të kufizuar veten dhe për të mos na treguar se ç'duhet të bëjmë, por shpreh pikëpamjet e veta.

Këto lloj takimesh mund të ofrojnë fillimet e një kulture bashkëpunimi të gjerë në qeveri, por ato nuk do të arrijnë të përçojnë këtë kulturë nëse nuk shoqërohen me kontakte të ngushta jozyrtare të punonjësve në nivele më të ulëta. Pa kontakte të tilla, procesi i informimit të bankës qendrore do të vuajë së tepërmi. Banka qendrore, për pasojë, duhet të investojë burime të konsiderueshme në vendosjen dhe në ruajtjen e këtyre kontakteve.

Për shembull, punonjës të veçantë në Rezervën Federale ngarkohen me të kuptuarin e serive të rëndësishme, siç janë indeksi i çmimeve të konsumit, të prodhuara nga agjenci të tjera. Këta punonjës mbajnë kontakte të shpeshta me punonjësit e Zyrës së Statistikave të Punës (BLS), agjencia që llogarit IÇK-në. Shpesh bisedat përqendrohen mbi atë se si BLS i trajton ngjarje të caktuara ose si i interpreton lëvizje të konsiderueshme në përbërësit e indeksit. Çështjet e rregullimit sezonal, gjithashtu, përbëjnë tema të rëndësishme diskutimi. E njëjta metodë zbatohet për të dhënat e pagave, punësimin, PBB-së e kështu me radhë.

Një tjetër shembull angazhon Ministrinë e Financave. Meqenëse banka qendrore është shpesh bankieri për pjesën tjetër të qeverisë, ajo duhet të ketë kanale nëpërmjet të cilave të informohet me kohë për ndryshimet e planifikuara në llogaritë e depozitave të qeverisë. Në SHBA, Thesari mban një llogari në bankën qendrore. Modeli i pagesave dhe i të hyrave nëpërmjet kësaj llogarie është i rëndësishëm për të kuptuar efektet e operacioneve të Thesarit në paranë rezervë. Ne punojmë ngushtë me punonjësit e Thesarit, për të realizuar parashikimin e afërt të gjendjes së llogarisë.

Për të vendosur dhe ruajtur kontaktet në nivel punonjësish në shembujt e mësipërm, ka tre tipare kyçe, të cilat do t'i trajtoj më poshtë:

1. Një punonjës duhet të ketë si përgjegjësi parësore seri të dhënash⁴. Ky person ka nevojë të kuptojë si agjencitë e tjera i llogarisin këto të dhëna. Kontaktet e pjesës më të madhe në nivel punonjësish me agjencitë e tjera duhet të mbahen nëpërmjet këtij personi. Ky person duhet të dijë, edhe duke përdorur vetëm telefonin, njerëzit të cilët mbledhin dhe përpunojnë të dhënat dhe duhet të kërkojnë edhe analizat ose interpretimet e lëvizjeve të rëndësishme në shifra.
2. Banka qendrore duhet të marrë pjesë në konferenca mbi çështje, që kanë lidhje me prodhimin e të dhënave që kanë interes për agjencitë e tjera qeveritare. Kjo konferencë është një shembull i mirë për këtë gjë. Banka qendrore mund edhe të organizojë konferenca të tilla, por edhe të çojë punonjësit e saj në konferenca të organizuara nga agjenci të tjera. Këto konferenca mund të përqendrohen në

⁴ Duhet të emërohet dhe një person rezervë në rastet kur dikush sëmuret ose merr lejen e zakonshme, por duhet të emërohet një person kryesor kontakti.

çështje, që i tërheqin vëmendjen spektrit të gjerë të ministrive dhe të agjencive, siç janë teknikat e rregullimit sezonal ose problemet e punonjësve të vrojtimit. Ato ofrojnë një rast të shkëlqyer për punonjësit që të takohen me homologët e tyre në agjenci të tjera.

3. Banka qendrore duhet të ketë diçka që ta ofrojë si shkëmbim. Askush nuk do të bashkëpunojë nëse përpjekja bëhet vetëm nga njëra anë. Çështja e pavarësisë nga pjesa tjetër e qeverisë, nganjëherë, mund ta bëjë bankën qendrore të duket si shumë kërkuese - ajo do atë që agjencitë e tjera e prodhojnë, por duket se u ofron shumë pak në këmbim. Për ta ndryshuar këtë perceptim banka qendrore mund të publikojë praktikisht çdo gjë që ajo grumbullon. Për shembull, lehtësia e përdorimit të të dhënave financiare që banka qendrore ka, mund të jetë e dobishme për punonjësit e Ministrisë së Financave, të cilët po përpiqen të kuptojnë efektet e politikës fiskale në tregjet financiare ose për një kërkues në INSTAT, i cili kërkon të kuptojë tendencën e çmimeve. Sot, me lehtësi përdorimi kuptohet publikimi në internet dhe një bankë qendrore duhet të ketë një faqe në internet lehtësisht të përdorshme dhe nga e cila mund të merren të dhënat. Së fundi, banka qendrore duhet të jetë e gatshme t'u përgjigjet pyetjeve për të dhënat e saj nga përdoruesit e tjerë të qeverisë⁵.

Zhvillimi dhe ruajtja e kontakteve ndërmjet punonjësve me agjencitë e tjera do të ndihmojë në sigurimin e informacionit të dobishëm dhe në kohë.

Megjithatë, punonjësit e bankës qendrore, kanë nevojë të mendojnë se si t'ia paraqesin këtë informacion politikëbërësve, çështje e cila trajtohet më poshtë.

3.2 INFORMIMI I POLITIKËBËRËSVE

3.2.1 Çfarë bën Rezerva Federale

Pjesa më e madhe e politikëbërësve janë njerëz jashtëzakonisht të zënë me punë. Shpesh ata nuk kanë kohë të përqendrohen në të gjitha të dhënat ekonomike, të cilat u vihen në dispozicion. Puna e punonjësve është që t'i përtypin këto të dhëna, të analizojnë tiparet më të rëndësishme dhe t'i paraqesin rezultatet në një formë lehtësisht të lexueshme.

Kjo është mënyra se si punonjësit i rrisin vlerën organizatës - duke transformuar të dhënat në informacion. Në vetvete, pjesa më e madhe e të dhënave përbëhen thjesht nga një numër shumë i madh shifrash, por duke u filtruar, ato mund të analizohen dhe mund të lidhen me të dhëna të tjera dhe kështu bëhen informacion, që politikëbërësit mund ta përdorin për të marrë vendime më të mira.

Në Rezervën Federale, punonjësit përgatisin një vlerësim të përgjithshëm të ekonomisë, tetë herë në vit dhe ky material përgatitet për takimet e këshillit tonë të mbikëqyrjes, i njohur me emrin Komiteti i Tregut të Hapur Federal (FOMC).

Ne kemi shumë punonjës dhe mbulojnë fusha të ndryshme të ekonomisë amerikane, por të dhënat dhe analiza e tyre përfshihen në një dokument të vetëm, të njohur me emrin Libri Jeshil për shkak të ngjyrës së kapakut të tij.

Ky libër trajton ekonominë jofinanciare në SHBA, sektorin financiar në SHBA dhe ekonomitë e huaja pasi ato lidhen me SHBA. Ai përmban një përmbledhje të zhvillimeve më të fundit, zakonisht qysh nga mbledhja e fundit e FOMC dhe një parashikim të bërë nga punonjësit. Parashikimi është i kushtëzuar nga ecuria e veçantë e politikës monetare dhe asaj fiskale.

Qëllimi i librit jeshil është që të ofrojë interpretimin që bëjnë punonjësit mbi atë se ç'ka ndodhur dhe çfarë pritet që të ndodhë.

Ai formon bazën për një prezantim që punonjësit i paraqesin FOMC dhe shpesh është pika e nisjes për diskutimet e Komitetit⁶.

⁵ Faqja në internet e një banke qendrore përdoret shumë edhe nga pjesëmarrësit privatë në tregjet financiare dhe nga publiku në tërësi, por ky diskutim përqendrohet në atë se ç'mund të bëjë një bankë qendrore për qeverinë.

⁶ Kjo është një pamje e thjeshtësuar e informacionit që merr FOMC. FOMC përbëhet nga anëtarët e Bordit të Guvernatorëve të Sistemit të Rezervës Federale (në thelb një bord drejtorësh të bankës qendrore) dhe Presidentët e vetë Bankave të Rezervës (në thelb drejtuesit e degëve kryesore të bankës qendrore). Punonjësit e Bordit përgatisin Librin Jeshil, por Presidentët e Bankave të Rezervës zakonisht kanë edhe informacione të përgatitura nga punonjësit e tyre. Përveç kësaj, midis mbledhjeve, çdo anëtar Komiteti mund të ndjekë shumë të dhëna financiare dhe jofinanciare të shtypura ose në formë elektronike. Së fundi, punonjësit parashikojnë efektet e mundshme të ndryshimeve në politikën monetare, të cilat jepen veçmas në një dokument të quajtur Libri

Ndërmjet mbledhjeve të FOMC, bëhen prezantime të rregullta javore për ta mbajtur Bordin në dijeni të zhvillimeve aktuale. Këto prezantime, trajtojnë sektorin e brendshëm jofinanciar, sektorin e brendshëm financiar dhe çështjet ndërkombëtare. Ato janë të shkurtra, dhe hedhin dritë mbi ato zhvillime që punonjësit mendojnë se janë të rëndësishme. Këto prezantime shoqërohen me një paketë të përditësuar të tabelave dhe të grafikëve që përmbledhin çdo sektor. Nëse nuk ka informacion të ri gjatë javës së mëparshme, punonjësit nuk përgatisin ndonjë prezantim po qe se nuk ka ndonjë temë të veçantë që paraqet interes për Bordin.

3.2.2 Ç'mund të bëjnë bankat e tjera qendrore

Nuk është e nevojshme që edhe bankat e tjera qendrore të bëjnë atë që bëjmë ne. Problemi kryesor i trajtimit të mësipërm është që banka qendrore duhet të ketë një plan kohor për të bërë të tilla prezantime të rregullta tek të cilat punonjësit të paraqesin dhe të interpretojnë të dhënat më të fundit. Këto dokumente duhet të koordinohen me planin e mbledhjeve të politikëbërësve. Në Shqipëri kjo do të thotë me mbledhjet dy herë në muaj që bën Këshilli Mbikëqyrës.

Punonjësit do të përgatisin prezantimin përmbledhës ose për Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorët së bashku përpara çdo mbledhjeje të Këshillit Mbikëqyrës, ose për krejt Këshillin Mbikëqyrës. Këto prezantime duhet të shoqërohen dhe me paketa standarde⁷. Ato duhet të jenë të shkurtra dhe të lënë kohë që politikëbërësit të bëjnë disa pyetje.

Kjo metodë ka disa përparësi. Së pari, rezultati i punonjësve kombinohet në një vend të vetëm, duke reduktuar nevojën që politikëbërësit të kontaktojnë me drejtorët e departamenteve të ndryshme veç e veç dhe ta organizojnë vetë informacionin. Së dyti, prezantimet i japin punonjësve një shans për të zgjeruar aftësitë e tyre sepse atyre u duhet të paraqesin informacion nga një shumëllojshmëri burimesh. Së treti, prezantimet nxisin një kulturë bashkëpunimi brenda organizatës. Ekziston prirja që të ndihmohet personin referues sepse herën tjetër do të jesh ti ai, që do të referojë dhe do të kesh nevojë për ndihmë.

Për të vendosur dhe ruajtur një proces eficient prezantimesh kërkohen disa ndryshime në mënyrën me të cilën veprojnë punonjësit.

Në Bankën e Shqipërisë, meqenëse Zëvendësguvernatorët janë anëtarë me të drejtë vote në Këshillin Mbikëqyrës, koordinimi i rezultateve të punës së punonjësve ka nevojë të bëhet nën këtë nivel. Me fjalë të tjera, duhet të ketë një grup, ndoshta të përbërë nga drejtuesit e departamenteve, i cili të mbikëqyrë këtë paketë prezantimi dhe të zgjedhë referuesit. Departamente të tilla, që kanë natyrë të pastër administrative si ai i Sigurimit dhe Mbrojtjes, i Burimeve Njerëzore, i Administrimit e kështu me rradhë, normalisht nuk kanë se ç'të përfshijnë në paketa të tilla, por pothuaj çdo departament tjetër mund të përfshijë diçka në periudha të ndryshme.

Blu. Ne ende nuk e kemi bërë një gjë të tillë, por funksionet e Librit Jeshil dhe të Librit Blu, mund të kombinohen në një dokument të vetëm.

⁷ Kjo paketë tabelash, grafikësh dhe vërejtjesh të përmbledhura mund të ndryshojë me kalimin e kohës pasi punonjësit të zbulojnë se cilat të dhëna japin një ide më të mirë të aktivitetit ekonomik në Shqipëri.